



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
D U R R Ë S

Nr.288/71036-980.Rregjistri
Datë 09.09.2016 Regjistrimi

Nr.10-2016-2659(197) Vendimi
Datë 05.12.2016 Vendimi

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Apelit Durrës e përbërë nga:

KRYESUES : Arben VRIONI
ANËTARE : Petrit ÇENO
ANËTAR : Anita MICI

Sot më datë 05.11.2016, asistuar nga sekretari Bledi Truma, me pjesmarjen e prokurorit Ludovik Dodaj, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen penale me **Nr.288/71036-980** akti që i përket:

KËRKUES: **Lulzim Berisha**, i biri i Adem dhe Rabije, i datelindjes 13.05.1971, lindur dhe banues ne Durres, mbrojtur ne gjykim nga avokati Miriam Moci, i zgjedhur me deklarim (ne mungese).

PALE E INTERESUAR: **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durres**, perfaqesuar nga Prokurori i Apelit z.Ludovik Dodaj.

OBJEKTI : **Lirim para kohe me kusht.**

BAZA LIGJORE: Neni 64 i Kodit Penal

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres me Vendimin Nr.(11-2016-3527) 328, date 28.07.2016 ka vendosur:

- Rrezimin e kerkeses se kerkuesit (te denuarit) Lulzim Berisha me objekt “Lirim para kohe me kusht”, si e pabazuar ne ligj.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen kerkuesit (te denuarit).

Ky vendim i është nenshtruar shqyrtimit nga Gjykata e Larte, e cila ka ndryshuar dy vendimet e mesiperme, duke e gjykuar ceshtjen ne fakt, ne funksion dhe te kontrollit te ligjshmerise se tij.

Gjykata e Larte me vendimin penal me Nr.175, date 16.07.2014, ka ndryshuar dy vendimet e mesiperme te dy shkalleve te gjykimit te Gjykates per Krime te Renda, duke e denuar kerkuesin Lulzim Berisha **me 25 vite burgim**, vuajtja e të cilit ka filluar që nga data e arrestimit të tij më datë 06.04.2006, duke marre ky shtetas dhe statusin e te denuarit.

Nepermjet vendimeve te gjykatave te te gjitha niveleve, i denuari Lulzim Berisha është deklaruar i pafajshem per kryerjen e vepres penale ne kuader te krimit te organizuar, duke u deklaruar nfajtor per kryerjen e tyre ne kushtet e bashkepunimit te thjeshte, sipas percaktimeve te nenit 25 te Kodit Penal.

Duke vlerësuar se përmbush kushtet për lirimin me kusht më datë 20.06.2016 i dënuari Lulzim Berisha ka paraqitur edhe kërkesën e tij sipas nenit 64 të Kodit Penal dhe gjatë gjykimit për të bazuar kërkesën e tij ka paraqitur në cilësinë e provave:

- Epikrizë percjellese e dates 21.09.2015 per nenen e tij Rabije Berisha, e cila është diagnostikuar me semundje te rende tumorale, leshuar nga komisioni i perbere nga tre mjeke te fushes.
- Epikrizë percjellese e dates 21.03.2016 per babain e tij Adem Berisha, leshuar nga komisioni i perbere nga tre mjeke, nga ku rezulton se babai i te denuarit vuan gjithashtu nga semundje.
- Karakteristike familjare e leshuar me date 08.07.2016 nga Kryetari i Bashkise Durrës Z. Vangjush Dako, ne te cilen gjen pershkrim gjendja e familjes se te denuarit Lulzim Berisha, marredehnet shume te mira te kesj familje me komunitetin ku jetojne, ku perfshihet babai i semure, nena me semundje tumorale, te cilet jetojne vetem dhe pa asnje mbeshtetje tjeter. Bashkia Durrës, duke vlerësuar gjendjen e kesaj familje, sjelljen e tyre ne komunitet, si dhe mundesine e liritimit te te denuarit, garanton punesimin e te denuarit Lulzim Berisha, ne pamundesi per t'u punesuar ne ndonje subjekt privat.
- Certifikata te perberjes familjare dhe personale te te denuarit, nga ku rezulton se ai është i divorcuar dhe ka tre femije ne moshe adoleshence.
- Aktualisht rezulton sipas certificates se perberjes familjare, se te dy prinderit e te denuarit Lulzim Berisha jane ne nje familje vetem me djalin e tyre, te denuarin, dhe jetojne vetem.
- Vertetim i gjendjes gjyqesore i dates 11.07.2016, nga e cila rezulton se, kerkuesi Lulzim Berisha nuk është denuar per veper tjeter penale te kryer me dashje.

Përveç sa më sipër, në zbatim të detyrimit ligjor, gjatë gjykimit nga ana e I.E.V.P Durrës jane paraqitur edhe dokumentacioni përkatës në lidhje me të dënuarin Lulzim Berisha, i cili, referuar dinamikës së vuajtjes së dënimit datë 02.12.2016, rezulton se ka vuajtur nga dënimi i dhënë me vendimin Nr.01, datë 16.01.2012 te Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, ndryshuar me vendimin me Nr.175, date 06.02.2015 te Gjykates se Larte, periudhen prej 18 vite e 9 muaj e 8 dite dhe se i kanë mbetur për të vuajtur edhe 6 vite 2 muaj e 22 ditë (përlllogaritja i referohet datës 02.12.2016 para Gjykates se Apelit). Ne kete mase denimi te vuajtur jane perfshire koha e vuajtur fizikisht, koha e perfituar nga koheqendrimi ne paraburgim dhe koha e perfituar